



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIU DHËN
01.01.2022 DERI 30.06.2022, BASHKIA DEVOLL”**

Tiranë 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje.....	4
I/2. Objekti i Auditimit	4
I/3. Qëllimi i Auditimit	4
I/4. Metodologjia e Auditimit.....	4
I/5. Konkluzioni.....	5
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË DEVOLL	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	51



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

I. PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 370, datë 19.05.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, në ambientet e Bashkisë Devoll, më datë 22.05.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Zj. E.K dhe Z. L. B, në prezencë të përfaqësuesit të Institucionit të audituar Zj. M.H, Zj. A.F, Zj. T.S, Zj. A.R dhe Zj. A.K.

I/1. Hyrje

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna datë 22.05.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Maliq, sipas programit të auditimit nr. 370 prot., datë 19.04.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E.K, përgjegjëse e grupit;
2. L. B, anëtar.

Auditimi ka filluar më datë 24.04.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 26.05.2023.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësisë dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësisë të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Devoll me shkresën nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se nga Bashkia Devoll kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e 25 rekomandimeve organizative, 4 rekomandimeve shpërblim dëmi, 3 rekomandimeve për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, 7 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, 1 rekomandim për uljen e borxhit tatimor dhe 24 masa disiplinore të lëna në total të cilat janë pranuar nga Bashkia Devoll.

Masa organizative

Nga 37 masa organizative, janë zbatuar 17 rekomandime, 14 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 6 rekomandime nuk janë zbatuar.

Masa shpërblim dëmi

Nga 5 masa shpërblim dëmi, janë zbatuar 3 rekomandime dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike

Nga 3 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, është zbatuar 1 rekomandim, 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, nga 13 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë zbatuar 3 rekomandime, 6 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 4 rekomandime nuk janë zbatuar.

Masa për uljen e borxhit tatimor

Nga 1 masa për uljen e borxhit tatimor, është zbatuar pjesërisht.

Masa Disiplinore pika D

Masa disiplinore për 24 persona e lënë, nuk është zbatuar.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelin 30 % si numër dhe 5 % si vlerë, gjë e cila tregon se nga subjekti është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve, por duhet të përqendrohet akoma më shumë në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërkimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenin 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË DEVOLL

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Devoll

Auditimi i fundit në Bashkinë Devoll është kryer në vitin 2022 për periudhën 01.01.2018-31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 37 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 5 masa për shpërblim dëmi, pranuar nga subjekti, në shumën 4,434,864 lekë;
- 3 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike, në shumën 98,023 lekë, pranuar nga subjekti;
- 13 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në shumën 48,390,855 lekë, pranuar nga subjekti;
- 1 masë për uljen e borxhit tatimor, në vlerë 46,204,726 lekë, pranuar nga subjekti;
- 24 masë disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Devoll duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Devoll për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022 ka kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditës, me shkresën 13.06.2022 dhe rezulton se është hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit me Urdhër nr. 185, datë 13.06.2022.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 muajor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Sipas verifikimit Bashkia Devoll ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 4042 prot., datë 22.11.2022 duke zbatuar afatin e caktuar.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Devoll ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku **përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Devoll

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Devoll 37 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë deri diku mirë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion është duke shkuar drejt një konsolidimi të plotë, por nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Rregullorja e Brendshme ka një konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar edhe kompetencave e akteve nënligjore në fuqi. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

“Menaxhimi i Riskut”

Nuk ka plan-veprime vjetore operationale të miratuar, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar

- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

- nuk është ndërmarrë dhe dokumentuar asnjë veprim për të adresuar mangësitë dhe përditësimi i regjistrit të riskut.

Hartimi i pjesshëm dhe jo në nivel Bashkie i regjistrit të riskut e i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut, ka sjellë mosidentifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

- Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuara nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Devoll mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Bashkinë Devoll aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëm dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Auditi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe Rregulloren e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Devoll.

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Devoll, të marren masa për:

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Kryerjen e investimeve në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

- Zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti.
- Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
- Përditësimin e Rregullores së Brendshme e Bashkisë Devoll, duke përcaktuar qartë mënyrat menaxheriale dhe përshkrimet e detyrave për çdo vend pune, përgjegjësit e punonjësve, si dhe raportimi i tyre në mënyrë periodike.
- Plotësimin e vendeve vakante të pozicioneve të larta drejtuese në bashki sipas organikës së miratuar, kjo për një menaxhim më të mirë të veprimtarisë së menaxhimit financiar e kontrollit në këtë bashki.

Në vijimësi

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll është përditësuar Rregullorja e Brendshme me Urdhër nr. 125, datë 28.03.2023 me nr. 1029 prot., datë 28.03.2023, është hartuar plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil për vitin 2023 me nr. 582 prot., datë 15.02.2023, është miratuar me Urdhër 126, datë 28.03.2023, “Për miratimin e kodit të pamjes dhe sjelljes profesionale të punonjësve të Bashkisë Devoll”, me Urdhër nr. 127, datë 28.03.2023, “Për miratimin e Kodit të Etikës të punonjësve të Bashkisë Devoll”, Urdhër nr. 09, datë 11.01.2023, “Për miratimin e strukturës së administratës të Bashkisë Devoll për vitin 2023”. Nuk është vendosur sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, nuk është zhvilluar program trajnimi për ngritjen profesionale të stafit.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB), rezulton se:

- Organizimi i NJAB- Bashkia Devoll, nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, pasi nga 3 Auditues të përcaktuar për të qene pjesë e njësisë, janë dy dhe nuk ka as përgjegjës.
- Nga drejtuesja e NJAB, nuk është kryer sigurimi i cilësisë së punës.
- Disa nga subjektet e audituara, pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, ato nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit.
- NJAB, pavarësisht planifikimit, nuk ka kryer angazhimin për auditim të Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo të planifikojë auditimin e procedurave të prokurimit pranë AK, Bashkia Devoll dhe Njësitë Administrative të saj.
- Nuk është kryer auditim në zonat me risk të lartë, si: prokurimet me vlerë të vogël dhe vlerë të lartë, lejet zhvillimore të lëshuara nga Sektori i PLZHT (*taksën e ndikimit në infrastrukturë*), shpenzimet operative (art. 602), për të gjitha llojet e blerjeve, administrim-menaxhim i Aseteve pronë e bashkisë nuk janë zhvilluar auditime të thelluara, zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve, menaxhimi i borxhit tatimore dhe rritja nga njëra periudhë në tjetrën, nuk është hartuar regjistri i riskut, etj., veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrisë Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Kap. VII, pika 7; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; neni 11 i VKM



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”; Standardet e Auditimit; -Rregulloren e brendshme të Bashkisë Devoll miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) Bashkia Devoll, të kryejë monitorimi në zbatim të rekomandimeve, si dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit Auditit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) Bashkia Devoll ka marrë masa për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve duke dërguar drejtorive dhe sektorëve shkresë me nr. 240, datë 20.01.2023, gjithashtu me shkresën nr. 1151/1, datë 01.04.2022 dhe nr. 1097/1, datë 03.04.2023 janë dërguar në MFE raporti vjetor i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm.

Rekomandimi është zbatuar

2.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e strukturës me Përgjegjës Sektori për një menaxhim më të mirë të punëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll nuk u paraqit dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është zbatuar (sipas observacionit mëposhtëm)

Për sa më lart, Bashkia Devoll, ka paraqitur observacion e protokolluar me shkresë nr. 1622 Prot., datë 01.06.2023, protokolluar në KLSH me nr. 370/9 Prot., datë 05.06.2023, ku citohet: **Pretendimet e subjektit:** janë ndjekur procedurat duke zbatuar aktet ligjore e nënligjore për plotësimin e limitit prej 20% për punonjës jashtë shërbimit civil, ndërsa për ngritjen në detyrë nuk ka patur kërkesa që të plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të pamatshme për kategoritë përkatëse. Bashkëlidhur struktura e plotësuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: pasi shqyrtoi kundërshtimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur, merr në konsideratë observacionin dhe bën ndryshimin e nevojshëm në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.3 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektive, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) Bashkia Devoll ka marrë masat e nevojshme duke dërguar informacion Këshillit Bashkiak me shkresë nr. 2872 prot., datë 26.08.2022 dhe nr. 675 prot., datë 24.02.2023

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

3. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Devoll dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Devoll.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Kështu për në vitin 2020, kanë ndodhur 6 ndryshime me vlerë 800,718 mijë lekë, në vitin 2021 kanë ndodhur 6 ndryshime me vlerë 114,493 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhetit në bashkëpunim me Sektorët e tjerë në Bashkinë Devoll, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhetit në bashkëpunim me Sektorët e tjerë në Bashkinë Devoll, për vitin 2022 buxheti ka ndryshuar me VKB nr. 47, datë 30.05.2022, nr. 51, datë 29.06.2022, nr. 55, datë 29.07.2022, nr. 59, datë 29.07.2022 dhe nr. 71, datë 12.10.2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me realizmin e investimeve publike, rezulton se, për vitin 2020 ky nivel paraqitet në masën 31.3%, ku nga vlera planifikuar prej 63,544 mijë lekë është realizuar vlera prej 19,892 mijë lekë. Ndërsa në vitin 2021 është realizuar në masën 54 %, ku nga vlera planifikuar prej 74,619 mijë lekë është realizuar vlera prej 40,584 mijë lekë.

Kjo situatë vjen si rezultat i planifikimit të procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 50% për asnjërin nga vitet objekt auditimi.

Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), si dhe nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin 2020 ato janë në shumën 57,268 mijë lekë, në fund të vitit 2021 në shumën 51,630 mijë lekë.

Veprime në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, gjatë vitit 2022 ka bërë pagesa për detyrimet e prapambetura, por ka pasur dhe shtesa, detyrimet në vlerë nga 51,630 mijë lekë në vitin 2021 kanë arritur në vlerën 115,580 mijë lekë në fund të vitit 2022, janë paguar fatura nga viti 2022 në vlerë 23,691 mijë lekë dhe janë shtuar detyrime në vlerë 10,297 mijë lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.2. Rekomandimi: Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit të tyre, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikuiduara), në fund të periudhave ushtrimore, duke planifikuar ato që kanë të bëjnë me shërbimet dhe investimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Devoll.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për të realizuar këtë rekomandim.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4.3. Rekomandimi: Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, shpërndarja e fondeve buxhetore është bazuar në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve.

Rekomandimi është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditor** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në **273** raste në vlerën **193,664 mijë** lekë nga e cila: për vitin 2020 janë **125** fatura me vlerë **106,273mijë** lekë dhe për vitin 2021 janë **148** fatura me vlerë **87,391mijë** lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizim i të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Gjithashtu nga Bashkia Devoll (Drejtoria e Financë/Buxhet), evidentohen dhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

mungesës së fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2020 – 31/12/2021, paraqiten gjithsej 5 fatura me vlerë **15,248 mijë** lekë.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (*përjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll për vitin 2022, kjo detyrë është marrë në konsideratë dhe janë bërë planifikim buxheti por kjo nuk varet vetëm nga Bashkia Devoll.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara në buxhetet respektive por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimi të fondeve nga Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Devoll nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se fondet e akorduara nga Ministritë e linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha, ku për vitin e parë nuk është respektuar kufiri 20% i vlerës së fondit limit. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Devoll për vitin 2020-2021 dhe grandeve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë.

Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Devoll (Sektori i buxhetit), nuk merr në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 70%, nuk ka në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të larta.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 - 80-81, të udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

6.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve, për çdo projekt të ri të financiar është respektuar masa 20% për vitin e parë të projektit dhe gjatë vitit 2022 ka planifikuar buxhetin për likuidimin e faturave të prapambetura të krijuara nga investimet dhe është respektuar plani i vitit për realizimin e plotë të tij, por nuk është miratuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

6.2. Rekomandimi: Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve, për çdo projekt të ri të financuar është respektuar masa 20% për vitin e parë të projektit dhe gjatë vitit 2022 ka planifikuar buxhetin për likuidimin e faturave të prapambetura të krijuara nga investimet dhe është respektuar plani i vitit për realizimin e plotë të tij, por nuk është miratuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve, për çdo projekt të ri të financuar është respektuar masa 20% për vitin e parë të projektit dhe gjatë vitit 2022 janë ndjekur hapa për likuidimin e faturave të prapambetura të krijuara nga investimet dhe është respektuar plani i vitit për realizimin e plotë të tij.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Devoll për vitet buxhetore 2020 dhe 2021, ka planifikuar të ardhurat e veta në vlera jo reale dhe të pa argumentuara, pasi ka një rritje artificiale të planit të të ardhurave, fenomen që vihet re edhe nga realizimi i tyre në nivele jo të mira.

Nisur nga ky fenomen gjatë planifikimit të buxheteve vjetore 2020 dhe 2021, Bashkia Devoll ka planifikuar të kryejë shpenzime kapitale dhe korrente bazuar mbi transfertës e pakushtëzuar dhe planit të të ardhurave jo real. Për rrjedhojë konstatohet një përqindje shumë e ulët e realizimit të investimeve të planifikuar, pasi fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (transfertë e pakushtëzuar), përdoret për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimeve në masën rreth 90% duke qenë se në Bashkinë Devoll rezulton një strukturë e organikës me numër të lartë punonjësish, tendencë kjo që ka ardhur në rritje nga viti në vit.

Në këto kushte Bashkia Devoll, për realizimin e investimeve të planifikuara është detyruar që për kontratat e lidhura për vitet 2020-2021 me burim financimi të ardhurat e veta, ngurtësimin e fondeve e ka shpërndarë në 3 vitet buxhetore në kundërshtim me ligjin për Buxhet si dhe për vitin e parë të financimit të këtyre kontratave nuk është respektuar limiti 20% e vlerës së kontratës duke treguar angazhim pa fonde në dispozicion.

Pesha kryesore e financimit të kontratave me burim të ardhurat e veta bie mbi vitin e tretë të financimit rreth 80% e vlerës totale.

Për sa më sipër nisur edhe nga fakti i realizimit të ulët të të ardhurave si dhe nga stoku i detyrimeve aktual në shumën **51,630 mijë lekë** projeksioni mbi vitet pasardhëse 2022 dhe 2023 për shpenzimet që duhet të kryejë për kontratat kryesore me burim financimi të ardhurat e veta është në shumën **146,482 mijë lekë**, për rrjedhojë do të çojë në vështirësi financiare dhe pa aftësi paguese të kontratave të lidhura në vitet 2020 dhe 2021.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtime nenet nr.50, nr.51 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pikat 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 65 79 -80-81-82, të udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të marrë masa për rishikimin e strukturës së punonjësve dhe rritjes së numrit të organikës e pa nevojshme, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Devoll.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll ka miratuar strukturën e re me Urdhër nr. 09, datë 11.01.2023, “Për miratimin e strukturës së administratës të Bashkisë Devoll për vitin 2023.

Rekomandimi është zbatuar

7.2. Rekomandimi: Sektori i Buxhetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi me të ardhurat e bashkisë të mos kryejë copëzimin e fondeve për të shmangur detyrimet e prapambetura që çojnë në një situatë të vështirë financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Buxhetit, ka planifikuar që periudha e investimeve të bëhet për 3 vjet në mënyrë që të realizohen projektet strategjike dhe më me rëndësi.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7.3. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme si dhe të hartojnë një plan për respektimin e disiplinës buxhetore për investimet kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, Grupet e Menaxhimit të Programeve, ka planifikuar që periudha e investimeve në mënyrë që të realizohen projektet strategjike dhe më me rëndësi.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i regjistrave të debitorëve në Bashkinë Devoll, konstatohet se vlera e debitorëve që rrjedhin nga detyrimet nga taksat dhe tarifave vendore për vitet objekt auditimi deri në 31.12.2020 nuk janë kontabilizuar. Vlera e debitorëve për subjektet fizik/ juridik (vetëm nga taksat dhe tarifave që mbledhen nga Sektori i Taksave dhe të Ardhurave) për vitin 2020 për subjektet juridike është në shumën prej **8,202,583 lekë**. Pra shihet qartë se sipas të dhënave nga regjistri për subjektet fizik/juridik për taksat dhe tarifave vendore në Drejtorinë e Financës nuk janë kontabilizuar debitorët e ndryshëm, si dhe nuk ka rakordim midis Drejtorisë së shërbimeve financiare dhe buxhetit dhe Drejtorisë së të ardhurave, lejeve dhe licencave, për të kryer kontabilizimin e tyre dhe paraqitjen reale të llogarisë 486 “Debitorë të ndryshëm” duke mos e debituar këtë llogari.

-Në analizë Gjobat e Inspektorati të mbrojtjes së Territorit (IMT)

Për vitin 2020 rezulton se nga Inspektorati i mbrojtjes së territorit, janë vendosur masa për **23** subjekte fizik/juridik në shumën **8,350,000 lekë**. Nga ana e IMT-së Devoll lista e gjobave për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

vitin ushtrimor nuk i është dërguar me shkresë përcjellëse sektorit të financës për rrjedhojë kjo shumë është e pa kontabilizuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vitin 2020, në debi të llogarisë 468 “Kreditorë të ndryshëm”.

Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke e debituar vlerën **16,552,583 lekë** për vitin 2020, për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore si dhe nga gjobat e IMT-së. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

Me mbylljen e pasqyrave financiarë Viti 2021

8.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet, nuk ka bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, për zbritjen e vlerave të projekteve apo shpenzimeve për mbikëqyrje nga gjendja e llog. 202 “Studime dhe Kërkime”, për investime të kryera në vite të mëparshme dhe që janë kapitalizuar si AQT, duheshin prerë artikuj kontabël për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivitetit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivitetit.

Për rrjedhojë duhej të ishte kredituar llog.202 “Studime dhe Kërkime”, për **6** studimet dhe projektimet në vlerën **12,281,610 lekë në debi** të llogarisë së aktivitetit përkatës, klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale.

-Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv.

-Nga auditimi i kontratave të lidhura për investimet në Bashkinë Devoll, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 rezultuan se, për kontrata punimesh të lidhura nga Bashkia Devoll, projekti është kryer nga operatorë ekonomikë privat si më poshtë:

Në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “H...” ShPK me nr.1279/3 prot, datë 05.06.2020, nga shoqëria “H...” ShPK është kryer dhuratë projekti “Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Sinicë, Qytezë, Vidohovë, Njësia Administrative Miras”.

Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë dhe të paraqitet te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llog.202 “Studime dhe Kërkime”.

Nga të dhënat e paraqitura konstatohet se në Drejtorinë e Financës/Buxhetit, nuk është paraqitur akt marrëveshja e dhurimit nr.1279/3 datë 05.06.2020, për rrjedhojë nuk është kryer kontabilizimi i projektit me vlerë kontabël sipas akt marrëveshjes. Kjo situatë tregon mos funksionimin e sektorëve dhe korrespondencës zyrtare midis tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

përgjithshme”; Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 57.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për regjistrimi në kontabilitet të projekteve të dhuruara në llog_202“*Studime dhe Kërkime*”, duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (*marrëveshja/akti i dhurimit*), si dhe Titullari i Institucionit të autorizojë rivlerësimin e tyre.

Nga ana e Sektorit të Financës për projektet të cilat aktivi ka përfunduar të merren masa për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivitetit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivitetit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

9.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, ka sistemuar në mbylljen e pasqyrave të vitit 2021 dhe projekti është bërë hyrja me dokumentin nr. 9, datë 23.03.2022.

Rekomandimi është zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Devoll, për pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, shërbime publike, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, të kaluara Bashkisë nga pushteti qendror me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish- Komunave/ Bashkive*”, nuk dispononte dokumente shoqërues si: harta me të dhëna mbi infrastrukturën, plan vendosjen e sipërfaqen, kufizimet, statusin e tregues të tjerë.

Nuk është kryer inventarizimi i këtyre pronave, duke kryer verifikimin në terren të gjendjes reale dhe statusin e tyre nga komisione të posaçme me specialist të fushës. Nuk ka aplikuar në ASHK Dega Devoll për regjistrimin e Aseteve, nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të Aseteve të Njësive Administrative për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të Bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, dhe dokumentimin në pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Kap. VII, neni 23, pika 14 “Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III- Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme, pika 30.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngriejë një grup pune me specialistë të fushës për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve të kaluara në pronësi të saj, duke përfshirë dhe Njësitë Administrative, si dhe të kryejë inventarizimin, regjistrimin e të gjitha asetëve në ASHK Dega Devoll, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin, kontabilizimin dhe pasqyrimin në aktivitetet e qëndrueshme në pasqyrat financiare.

Menjëherë

10.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka ngritur një grup pune për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe asetëve të kaluara në pronësi të saj, por janë por



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

janë nxjerrë 60 certifikata pronësie deri në fund të vitit 2021 dhe për vitin 2022 janë nxjerrë 6 certifikata pronësie.

Rekomandimi është zbatuar (sipas observacionit mëposhtëm)

Për sa më lart, Bashkia Devoll, ka paraqitur observacion e protokolluar me shkresë nr. 1239/I Prot., datë 23.06.2023, protokolluar në KLSH me nr. 370/19 Prot., datë 27.06.2023, ku citohet: **Pretendimet e subjektit:** është ngritur Urdhri nr. 225, datë 12.06.2023 dhe nr. 1747 Prot., “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe inventarizimin e pronave në pronësi të Bashkisë Devoll”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: pasi shqyrtoi kundërshtimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur, merr në konsideratë observacionin dhe bën ndryshimin e nevojshëm në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analitiku të llog.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në Bashkinë Devoll, rezulton se për **3** objekte me vlerë **95,795 mijë lekë** dhe analitiku i llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për **3** objekte me vlerë **572,125 mijë lekë**, nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për këto objekte të trashëguara nga ish-komunat por të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2020 në Bashkinë Devoll, ka një ndikim të konsiderueshëm në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra në lidhje me pohimet financiare, për rrjedhojë nuk përmbushin kriteret e plotësisë së një aktivi, mos ekzistencën e informacionit kontabël si dhe vërtetësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” dhe në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF, si dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

11.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë asnjë masë për realizimin e këtij rekomandimi dhe nuk u paraqit asnjë dokument.

Rekomandimi është zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 020, rezulton se për llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të veçantë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 10,12,81,83,85,86 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të krijuar dhe mbajtur regjistrimin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

12.2 Nga verifikimi rezultoi se, nga Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, ka plotësuar vendin vakant dhe po vazhdon puna për realizimin e një regjistri aktivesh.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin ushtrimorë 2020 nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr.312 datë 23.10.2020, është ngritur grupi “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune, inventar ekonomik”.

Urdhri është për daljen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabilitetit për inventarët në shumën 3,705,982 lekë, nga e cili: inventar i imët (llog. 237-1) 2,153,73 lekë, inventar (llog. 214) në shumën 264,628 lekë dhe inventar ekonomik (llog. 218) në shumën 1,287,615 lekë .

Nga grupet e punës janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Devoll, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, të cilat janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Devoll.

Te përshkrimi i dhënë në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për t’ua rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik.

Nga verifikimi i listës së materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik, rezulton se ka një pjesë të konsiderueshme të materialeve me profil drusor dhe metalik të cilët duheshin bërë hyrje dhe rishitur me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, këto për shumën prej 264,628 lekë të shkarkuara nga kontabiliteti (llog214 “Makineri dhe pajisje), janë materiale me profil metalik, (llog.218 “Inventar ekonomik”), janë materiale me profil drusor (banka, tavolina, karrige, raftë drusor) për të cilat duhet të ishin grumbulluar dhe të shiteshin në ankand.

Nga ana e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit në proces verbalet e mbajtura nuk paraqiten dokumente mbështetës ku të përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve (në ndryshimin e formës fillestare, groposur ose djegur), si dhe për materialet me profil druri dhe metalik nuk janë përdorur si materiale të riciklueshme, të shiteshin në formë ankandi ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 104, 109 dhe 110.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa dhe të nxirren përgjegjësitë për komisionet që kanë kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve me profil drusor dhe metalik duke mos i bërë hyrje në magazinë me qëllim që më pas të shiteshin në formë ankandi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Menaxhimit Strategjik, ka bërë hyrjen në magazinë me fletë hyrjen nr. 15 dhe 16, datë 07.04.2023, është zhvilluar procedura e ankandit dhe është lidhur dhe kontrata.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Për sa më lart, Bashkia Devoll, ka paraqitur observacion e protokolluar me shkresë nr. 1258/2 Prot., datë 01.06.2023, protokolluar në KLSH me nr. 370/9 Prot., datë 05.06.2023, ku citohet:

Pretendimet e subjektit:

Sektori i Menaxhimit Financiar ka bërë hyrje nr. 15 dhe 16, datë 07.04.2023, procesi i ankandit ka përfunduar, është lidhur kontrata, prerë fatura dhe nga ana e subjektit fitues është kryer pagesa me mandat arkëtimin me datë 19.05.2023. (mandati bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: pasi shqyrtoi kundërshtimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur, merr në konsideratë observacionin por gjithashtu sqarojmë se lidhur me masën e dhënë nuk është marrë masë nga Bashkia për të nxjerrë përgjegjësitë për komisionet.

13.2. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik, për vitin ekzistues të hartojë një procedurë të drejtë dhe në përputhje me Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, i ndryshuar për komisionet që do të ngarkohen për vlerësimin dhe asgjësimin e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, është hartuar Vendimi nr. 73, datë 14.10.2021, “Për miratimin e manualit të proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore në Bashkinë Devoll”.

Rekomandimi është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se:

- Bashkia Devoll nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 7.4.1999 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Devoll SHA me NUIS J..., e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij”.

Numri i aksioneve është 221,410 lekë/aksion me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **221,410,000 lekë**.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Devoll në “Ujësjiellës Kanalizime Devoll “ SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llog.26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

- Bashkia Devoll nga verifikimi i të dhënave në QKB, rezulton se në datën 5.6.2008 paraqitet si aksionare me 11% të aksioneve të shoqëria “K...” me NUIS K... e cila është shoqëri aksionare me objekt “Mbledhje, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale”.

Numri i aksioneve është 25 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **413,750 lekë**. Kjo vlerë e kapitalit me **11%** aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Devoll në shoqërinë “K.. “ SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llog.26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Në rastin tonë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) **221,823,750 lekë** dhe Investitori është Bashkia Devoll. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **221,823,750 lekë** përbën mos pasqyrim të informacionit financiar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhërin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Devoll” SHA me vlerë kontabël **45,434,140 lekë**, si dhe regjistrimin e pjesëmarrjes me 11% të kapitalit aksionar të “K...” me vlerë kontabël **413,750 lekë** në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

14.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, për “Ujësjellës Kanalizime Devoll” SHA, për vlerën 45,434,140 lekë është shkëputur nga Bashkia Devoll dhe ka kaluar në Korçë, ndërsa për “K...” me vlerë kontabël 413,750 lekë Bashkia nuk ka kontabilizuar vlerën sipas rekomandimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për objektet të cilat janë në proces investimi dhe nuk janë marrë në dorëzim, nga ana e sektorit të financës janë kapitalizuar tek klasa e aktiveve afatgjata materiale, në vlerën e situacioneve deri në 31.12.2020, veprim është kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 18.

Nga lëvizjet kontabël të llog. 231 “Investime në proces” për vitin ushtrimor 2020, rezulton se janë **16** objekte në vlerë kontabël **96,055,495 lekë**.

Për këto 16 objekte edhe pse nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Devoll, në pasqyrën e pozicionit financiar ato paraqiten në klasën e aktiveve afatgjata materiale. Këto objekte të pa përfunduara duhet të pasqyroheshin në llog.231 “Investime në proces” dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit.

Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu 2 “Klasa 2 Aktivet Afatgjata” Përbërja dhe trajtimi kontabël”.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll të bëjë sistemimi në kontabilitet të llog.231 “Investime në proces”, duke kryer veprimin kontabël në debi të llog.231 për shumën prej **96,055,495 lekë**, të investimeve në proces, në kredi të llogarive në klasën e aktiveve afatgjata materiale. Në momentin e marrjes në dorëzim të aktiveve vlera e plotë e Investimit të kapitalizohet më pas te klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

15.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, ka kontabilizuar të gjithë faturat në llogarinë 231 “Investime në proces”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Rekomandimi është zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se në llog.230 “Investim në proces për aktive afatgjata jo-materiale” vlera kontabël **8,095,000 lekë** përfaqëson projekte të trashëguara për të cilat nuk ka kartela.

Këto projekte të cilat janë të përfunduara pasi janë trashëguar nga ish-komunat duhet të ishin kapitalizuar tek klasa e aktiveve afatgjata jo-materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit.

Mungesa e analizës për këto aktive të trashëguara nga ish-komunat, por të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2020 në Bashkinë Devoll, ka një ndikim të konsiderueshëm në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra në lidhje me pohimet financiare, për rrjedhje nuk përmbushin kriteret e plotësisë së një aktivi, mos ekzistencën e informacionit kontabël si dhe vërtetësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale

U konstatua një klasifikimi gabuar i vlerës së këtyre **projekteve**, të cilat nuk janë kapitalizuar si aktiv te klasa e Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale në vlerën kontabël prej **8,095,000 lekë**.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 2 “Klasa 2 Aktivitet Afatgjata” Përbërja dhe trajtimi kontabël”.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të bëjë sistemimin në kontabilitet të llog.230 “Investime në proces” dhe llog.202 “Studime dhe kërkime” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej **8,095,000 lekë** të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llog.202 dhe në kredi të llog.230

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

16.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll, nuk ka marrë masa për realizimin e rekomandimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se në llog.437,438 “Organizma të tjerë shtetërore” vlera kontabël **18,893,310 lekë** përfaqëson një investim të kryer nga ish-komuna Progër sipas kontratës të lidhur nga kjo komunë me shoqërinë “A...” ShPK me nr.2 datë 18.06.2013 me objekt “Rehabilitimi i rrugës së fshatit Cangonj”. Vlera e kontratës është 30,762,165 lekë me TVSh, ku deri në vitin 2020 është likuiduar vlera 11,778,856 lekë. Nga të dhënat e sektorit të financës rezulton se pjesa tjetër e kontratës nuk është realizuar dhe investimi ka përfunduar me fondet e siguruar nga projekti TAP.

Vlera kontabël prej 18,983,310 lekë e cila përfaqëson pjesën e investimit të kryer nga ish-komunat Progër, në vitin ushtrimor të konsolidimit të pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll, duhej të kapitalizohej në klasën e aktiveve afatgjata materiale si investim i kryer dhe jo në llog. 437 “Organizma të tjerë shtetërore”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika nr.18 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 7-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll të bëjë sistemimin në kontabilitet të llog.437 - 438 “Organizma të tjerë shtetërorë” për vlerën kontabël 18,983,310 lekë në debi të klasës së aktiveve afatgjata materiale pasi është investim i marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

17.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, ka bërë sistemimin e llogarisë 437 - 438 “Organizma të tjerë shtetërorë”.

Rekomandimi është zbatuar

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se Llog. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 6,362,743 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 16 objekte nga të cilat për 8 objekte në vlerën prej 3,377,598 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuara deri në vitin 2018, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Sektori i Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhblllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Veprime në kundërshtim me ligjin 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10”; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të marrë masa për të bërë sistemimin e llog. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

18.2 Nga verifikimi rezultoi se, Nga ana e Drejtorisë së Financës/Buxhet në Bashkisë Devoll janë marrë masat duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. Për vitin 2021 nga shuma 6,362,743 lekë e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5% për vitin 2020 janë likuiduar 2,649,910 lekë. Për pjesën e mbetur e cila i përkon ish komunave është tejkaluar afati i garancisë së punimeve (12 muaj), kjo krijon konfuzion mbi shprehjen e gjendjes së objektit nga ana e komisionit të ndjekjes së punimeve. Përgjatë vitit 2021 llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është shtuar me 6,511,961 lekë për objektet që janë financuar gjatë vitit 2021. Për vitin 2022 llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është shtuar me 11,045,040 lekë për objektet që janë financuar gjatë vitit 2022 dhe janë likuiduar 641,959 lekë gjatë vitit 2022 për objektet që kanë plotësuar afatet e garancisë dhe janë plotësuar dokumentet justifikuese. Gjendja në datën 31.12.2022 e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” paraqitet në vlerën 20,627,875 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

19.Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018, 2019 dhe 2020 kemi përpunuar të dhënat, gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale.

Nga testimi i saktësisë së llog.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” si llogari debitore dhe testimin e saktësisë së llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” si llogari kreditore të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve.

Detyrimet nga kontratat për investime publike:

1. Kontrata nr.25 datë 05.12.2019 me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Bilisht-Vernik loti I*”, e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A...” shpk, me vlerë kontrate 38,746,432 lekë, me burim financimi nga “Donatorë, qeveria Bullgare”.

Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria “A...” ShPK ka paraqitur 2 fatura në vitin 2020, me vlerë **6,482,261 lekë**, të likuiduara në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” me kundërparti llog.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” te pasqyra e pozicionit financiar.

2.Kontrata nr.4 datë 18.06.2020 me objekt “*Zgjerimi i rrugëve aks superstrada e devollit*”, e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe bashkimit të OE “A...” & “N...”, me vlerë kontrate **99,236,740 lekë**, me burim financimi nga “të ardhurat e Bashkisë”.

Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: bashkimi i OE “A...” & “N... ShPK” kanë paraqitur 3 fatura tatimore në vitin 2020, me vlerë 6,200,000 lekë, të likuiduara në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” me kundërparti llog.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”

3. Kontrata nr.25 datë 24.11.2020 me objekt “*Burimi i ujësjellësit i fshatit Tren*”, e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “S...” ShPK, me vlerë kontrate **569,311 lekë**, me burim financimi nga “të ardhurat e Bashkisë”.

Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria “S...” ShPK ka paraqitur 1 (një) faturë tatimore në vitin 2020, me vlerë 569,311 lekë, likuiduar në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” me kundërparti llog.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”.

4.Kontrata me objekt “*Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë*”, e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe SHA “K...”, me pagesa të pritshme vjetore 7,981,705 lekë me TVSh, me burim financimi nga “të ardhurat e Bashkisë”.

Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria “K...” ka paraqitur fatura tatimore në vitin 2020, me vlerë 4,701,475 lekë, e cila është likuiduar në vitin 2020 vlera 2,322,919 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar pjesa tjetër e detyrimit në vlerën **2,378,556 lekë** në llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” me kundërparti llog.486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”.

Pra nga testimi i pagesave me bankë dhe i dokumentacionit shoqërues për vitin 2020 dhe vitin 2021, rezultoi se në gjendjet në bilancin e vitit ushtrimor 2020 nuk është përfshirë shuma prej 15,568,491 lekë.

Për vitin ushtrimor 2020, gjendja e llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” prej 61,489,880 lekë nuk rakordon me vlerën reale të detyrimeve që rrjedhin nga faturat e palikuiduara për mallra, shërbime, investime, detyrime nga vendimet gjyqësore të pa paguara dhe detyrimet të pa paguara nga shpronësimet, duke mos u paraqitur në analitikun e llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, shuma prej **15,568,491 lekë**. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si rrjedhojë mospërfshirjen e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi I “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, 42.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, të marrë masa që të evidentohen detyrimet në pasqyrat financiare duke i njohur në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

19.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, në pasqyrat e vitit 2021 janë njohur detyrimet në kundërparti llogaria 85, sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

Rekomandimi është zbatuar

19.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llog.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për shumën **15,568,491 lekë** për vitin ushtrimor 2020.

Me mbylljen e pasqyrave financiare Viti 2021

19.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, në pasqyrat e vitit 2021 janë njohur detyrimet në kundërparti llogaria 85, sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

Rekomandimi është zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të Drejtorisë së të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve, Bashkia Devoll, rezulton se struktura ka probleme dhe nuk është në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, e cila ti shërbejë Bashkisë Devoll në realizimin e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm të Drejtorisë së të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve, ku numri i debitorëve është shumë i lartë, gjithsej për vlerën **41,410,030lekë**, duke e bërë të vështirë zbatimin e procedurave për arkëtimin e debitorëve në zbatim të pikës (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për riorganizimin e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, duke emëruar drejtorin e kësaj drejtorie (si vend vakant) dhe krijimin Sektorit të Menaxhimit të Borxhit.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

20.2 Nga verifikimi rezultoi se, me miratimin e strukturës së vitit 2023 me Urdhër nr. 09, datë 11.01.2023, “Për miratimin e strukturës së administratës të Bashkisë Devoll për vitin 2023”, është krijuar sektori i menaxhimit të borxhit.

Rekomandimi është zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi të ardhurat e realizuara për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2021), rezulton se megjithëse të ardhurat nuk janë realizuar në asnjë nga periudhat ushtrimore, nga Bashkia Devoll në planifikimin e të ardhurave evidentohet një rritje e nivelit të tyre, ku për vitin 2018 kjo është me e theksuar, pasi kemi një rritje prej 88% ose në vlerë prej 76,508 mijë lekë.

Kjo rritje e paargumentuar, gjë e cila konstatohet dhe nga mos realizimi i të ardhurave në asnjë periudhë ushtrimore të auditimit, bëhet me qëllim që Bashkia Devoll të rrisë artificialisht fondet në buxhetet e viteve respektive për miratimin e shpenzimeve si në paga, shpenzime operative, për investime etj, të cilat në fund të periudhave ushtrimore mbesin të palikuiduara si rezultat i mos realizimit të të ardhurave, duke çuar në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku më 31.12.2021 paraqitet në **vlerën 51 milionë lekë**, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, gjatë hartimit të projektit/planit të të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore, të planifikojë saktë treguesit e planit mbi baza reale, duke u mbështetur në mundësitë reale të aktivitetit në bashkinë Devoll, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të të ardhurave, duke respektuar kuotën 10% rritje nga njëri vit në tjetrin.

Në vijimësi

21.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, ka respektuar kuotën 10% nga viti 2022 në vitin 2023, por realizimi i të ardhurave për vitet në vijim vazhdon të mos realizohet.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

22. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet mujore dhe vjetore, por që janë të paplota, pasi në to nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK (nga shitja e pasurisë), Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugorë (për mjetet qarkullues), Drejtoria Rajonale Tatimore Devoll (tatim fitim thjeshtuar) dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizim sha (abonentët familjarë).

Bashkia Devoll nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Për sa më sipër, Bashkia Devoll nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimet të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Devoll është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektësh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Devoll duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Veprime në kundërshtim me ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, ka bërë rakordim me MIE, me Postën ShA dhe Ujësjellës Kanalizime Korçë me shkresë nr. 526, datë 09.02.2023, nr. 956, datë 21.03.2023, nr. 1275, datë 25.04.2023, etj.

Rekomandimi është zbatuar

22.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e proceduarve të prokurimit, rezulton se:

a-Për disa procedura projektet/ preventivat janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Devoll dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Devoll, por të papajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë, si:

1- *Procedura me objekt: “Rehabilitim i rrugëve të qytetit Bilishti 2”, viti 2021 me fond limit 71,416,666 lekë.*

2- *Procedura me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistues për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara”, viti 2019 me fond limit 16,773,145 lekë.*

b- Dosjet e procedurave të prokurimit edhe pse ishin mbyllur në të gjitha fazat e tij, nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e Bashkisë Devoll.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 13 dhe 29 “Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë”, neni 22 “Plani i detajuar vendor”, neni 37 “Kushtet për zhvillim”, neni 38 “Leja e zhvillimit”; neni 39 “Leja e ndërtimit”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit, kreu III, neni 5 dhe neni 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca –kategoritë e punimeve”. Ligji nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”; nenin 4/26.

23.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa për kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që projektet të jenë sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll, për procedurat në vijim të gjithë projektet janë realizuar me procedurë prokurimi.

Rekomandimi është zbatuar

23.2.Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Devoll, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Devoll, në vijim dosjet e procedurave të prokurimit janë inventarizuar në bashkëpunim me specialistin e zyrës së arkivës.

Rekomandimi është zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerë karburanti për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, pasi:

Vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë gjendje në magazinë, analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (motogenerator, kaldaja, etj.) në qarkullim, sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, etj. Për sa i përket vlerës së përlllogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk është analizuar e krahasuar në përlllogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar.

Veprime në kundërshtim me neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”.

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të marrë masa për ngritjen e një strukture të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll me miratimin e buxhetit, konkretisht me Vendim nr. 97, datë 29.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023”, por nuk është ngritur një strukturë e veçantë për planifikimin vjetor për nevojave për karburant.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

25. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në Bashkinë Devoll mbi zbatimin e aktmarrëveshjes nr. 1359, datë 16.4.2019 të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A... “ ShPK, rezulton se:

Nga komuniteti i NJA Miras Devoll është paraqitur ankesë në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Dega Korçë. Në të ankesës me shkresën nr. 122, datë 07.11.2018 IKMT Bashkia Korçë i është drejtuar IMT Bashkia Devoll që mbështetur në nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të bëhet verifikimi i ankesës, mbi punimet që po kryhen për ndërtimin e Hidrocentralit në Qytezë, sipas të cilave ka sjellë dëmtim të rrugëve dhe ndryshim në mjedis.

Me shkresën nr. 3321/1, datë 16.11.2018, Bashkia Devoll (të cikuar nga Zv. Kryetari z. S.H, mungesë dhe porosi) ka informuar IKMT Bashkia Korçë mbi verifikimin e shkresës së saj nr. 122/, datë 7.11.2018, ku ndër të tjera thuhet se: “Bashkia Devoll ka ngritur grupin e punës me përfaqësues të disa sektorëve dhe ka kryer inspektimin në terren, ku ka dalë me vendim nr. 29, datë 14.11.2018 mbi bazën e të cilit nga Policia Bashkiake është mbajtur procesverbal datë 14.11.2018, për pezullimin e punimeve deri në paraqitjen e plotë të dokumentacionit pranë zyrave të Bashkisë Devoll (bashkëlidhur Raport Auditimit gjendet procesverbali).

Në procesverbalin e datës 14.11.2018 të mbajtur nga Policia Bashkiake, thuhet se: “Në zbatim të vendimit nr. 29, datë 14.11.2018 për inspektimin në subjektin “Muso HC Qytezë”, i cili kryhen punime në aksin e lartpërmendur, u konstatua disa punëtorë dhe ju interpretuan parregullsi të cilat janë konstatuar nga sektorët përkatës nga Bashkia Devoll.

Nga auditimi më tej i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se ndërmjet institucionit Bashkia Devoll përfaqësuar nga z. B.N dhe shoqërisë ”A...”, është lidhur aktmarrëveshje nr. 1359, datë 16.4.2019 (noterizuar me nr. 670, datë 16.04.2019) me objekt:

1- “.....financimi nga shoqëria “A...” ShPK i materialeve të ndërtimit dhe karburanti që do të përdorin mjetet për ndërtimin për ndërtimin e rrjetit të jashtëm për furnizimin e ujësjellësit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

fshatit Miras nga burimi i valës të Sinicës, sipas projektit të hartuar për këtë qëllim në përputhje me specifikimet teknike të tij, të miratuara nga Bashkia Devoll”.

2- Zbatimi i këtij projekti do të vlerësohet si investim në komunitet i shoqërisë “A...” shpk, e cila aktualisht është shoqëri koncesionare dhe po ndërton në territorin e Bashkisë Devoll HEC Qytezë.

Nga ana e Bashkisë Devoll, zyra e Planifikim Zhvillimit Territorit përfaqësuar nga ing. R. H. është hartuar preventivit i punimeve për ujësjellësin e Mirasit për vlerën 17,930,380 lekë, ku vlera e bazës materiale paraqitet në shumën 9,877,823 lekë.

Sipas nenit 7 të aktmarrëveshjes shoqëria “A...” ShPK, duhet që brenda 14 ditëve të dorëzonte në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime SHA Devoll mostrat e materialeve për miratim dhe brenda një jave do të sigurojë furnizimin, duke dorëzuar materialet me procesverbal dorëzimi të detajuar sipas preventivit. Nga ana e shoqërisë nuk është bërë i mundur respektimi i afateve të përcaktuara në këtë aktmarrëveshje për dorëzimin e materialeve, kjo për arsye të ndryshme. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga magazina e “Ujësjellës Kanalizime Devoll” sha, e përfaqësuar nga z. M..., rezulton se nga shoqëria janë dorëzuar këto materiale:

a- Sipas FD nr. 1006, datë 25.4.2019 mostrat e materialeve;

b- Sipas PV nr. 157, datë 6.6.2019 dhe në zbatim të akt-marrëveshjes është bërë dorëzimi i një sasi materiali “T... PERC100Dj = 110 mm, PN 10, 2500 ml.

Pra nga të dhënat e magazinës nuk ka asnjë sasi tjetër materiali të dozuar në “Ujësjellës Kanalizime Devoll” SHA, sipas projektit të hartuar nga Bashkia dhe rënë dakord me shoqërinë “A...” shpk, e konkretizuar në aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.04.2019.

Nga sa trajtuar më sipër, rezulton se aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.04.2019 e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A...” ShPK, nuk është zbatuar e plotë, referuar qëllimit të saj për të cilën është hartuar dhe nënshkruar nga palët.

25.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialist të fushës dhe të analizojë shkaqet dhe rrethanat e mos zbatimit të aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.4.2019 të lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A...” ShPK, me objekt: *...financimi nga shoqëria “A...” ShPK i materialeve të ndërtimit dhe karburanti që do të përdorin mjetet për ndërtimin e rrjetit të jashtëm për furnizimin e ujësjellësit të fshatit Miras nga burimi i valës të Sinicës, sipas projektit të hartuar për këtë qëllim në përputhje me specifikimet teknike të tij, të miratuara nga Bashkia Devoll, duke konkluduar mbi këtë aktmarrëveshje dhe nxjerrjen e përgjegjësi.*

Menjëherë

25.2 Nga verifikimi rezultoi se, është ngritur grupi i punës me Urdhër nr. 341, datë 19.09.2022 i cili nuk është shprehur deri më tani mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së lidhur midis Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A...” ShPK.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Masa për shpërblim dëmi

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën **4,434,864 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Zgjerimi i rrugës vendore, aks Superstrada e Devollit – Ismail Qemali, Demir Progri –Aks



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

rruga Ethem Osman Xhaci dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, Lagjja nr.2 dhe “Lagjja nr. 3”, Bashkia Devoll, me vlerë të kontratës (me TVSh)99,236,740 lekë, fituar nga bashkimi i OE “N...” SHPK & “A...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 389,200 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1463 prot datë 16.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe BOE “N...” SHPK & “A...” SHPK.

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **389,200 lekë pa TVSh** nga bashkimi i OE “N...” SHPK & “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1463 prot datë 16.06.2020, me objekt “Zgjerimi i rrugës vendore, aks Superstrada e Devollit – Ismail Qemali, Demir Progri –Aks rruga Ethem Osman Xhaci dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, Lagjja nr.2 dhe “Lagjja nr. 3”, Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.7.2022

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 389,200 lekë pa TVSh, duke njoftuar me shkresën 2934 prot., datë 01.09.2022 dhe 2934/1, datë 01.09.2022 dhe arkëtuar këtë vlerë me pagesat me numër veprimi 005784 dhe 005785, datë 07.09.2022. (Për vlerën totale 943,200 lekë duke përfshirë edhe vlera të mëparshme për rekomandimet në vijim, 2.1 dhe 3.1)

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti I, Rehabilitimi i rrugëve të qytetit Bilisht”, Bashkia Devoll, me vlerë të kontratës (me TVSh)41,999,663 lekë, fituar nga OE “N...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 330,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3028 prot datë 28.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe OE “N...” SHPK.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **330,000lekë pa TVSh** nga OE “N...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3028 prot datë 28.12.2018, me objekt “Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti I, Rehabilitimi i rrugëve të qytetit Bilisht”, Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.7.2022

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 389,200 lekë pa TVSh, duke njoftuar me shkresën 2934 prot., datë 01.09.2022 dhe 2934/1, datë 01.09.2022 dhe arkëtuar këtë vlerë me pagesat me numër veprimi 005784 dhe 005785, datë 07.09.2022. (Për vlerën totale 943,200 lekë duke përfshirë edhe vlera të mëparshme për rekomandimet në vijim 1.1, 3.1)

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti II, Rehabilitimi i Rrugëve në NjA Miras”, Bashkia Devoll, me vlerë të kontratës (me TVSh)29,396,869 lekë, fituar nga OE “A...” SHPK,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 224,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3028 prot datë 28.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe OE “A...” ShPK.

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **224,000lekë pa TVSh** nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3028 prot datë 28.12.2018, me objekt “Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti II, Rehabilitimi i Rrugëve në NjA Miras”, Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.7.2022

3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 389,200 lekë pa TVSh, duke njoftuar me shkresën 2934 prot., datë 01.09.2022 dhe 2934/1, datë 01.09.2022 dhe arkëtuar këtë vlerë me pagesat me numër veprimi 005784 dhe 005785, datë 07.09.2022. (Për vlerën totale 943,200 lekë duke përfshirë edhe vlera të mëparshme për rekomandimet në vijim 1.1 dhe 2.1).

Rekomandimi është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekti “Shërbimi i pastrimit Bashkia Devoll” me fond limit 48,826,042 lekë me afat 3 vjeçar, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “A...” ShPK, me vlerë kontrate 48,607,640 lekë, rezulton se në zbatimin në fakt të kontratës numri i punonjësve në terren nuk është i njëjtë me numrin e punonjësve sipas llogaritjes së fondit limit (31 punonjës), dhe të kërkuara në DST (50 punonjës), pasi ky shërbim kryhej për 27 punonjës.

Si rezultat Bashkia Devoll, gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të bëhet rivlerësim i vlerës së kontratave vjetore për tre vite në **3,491,664 lekë**, për një përdorim me efektiv dhe efikasitet të fondit të prokuruar, kjo në raport me numrin e punonjësve në fakt për zbatimin e kontratës, duke e bërë zbritje nga vlera e kontratës fillestare të lidhur në fillim, pasi:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se nga Bashkia Devoll nuk është hartuar plan vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në territorin që ka nën juridiksion, nuk është marrë asnjë masë për grumbullimin e mbetjeve në mënyre të diferencuar, nuk bëhet menaxhimi i mbetjeve referuar piramidës së menaxhimit të mbetjeve (*parandalim, riciklimi, ripërdorim*), veprime këto në kundërshtim me nenet 10, 12, 14 dhe 18 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Në dosjen e zbatimit të kontratës të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve z. F.Z është në kundërshtim me kontratën dhe specifikimet teknike të paraqitura në DST, pasi mungonte dokumentacioni si vijon:

- Planet e punës dhe grafikët e punimeve të miratuara nga AJ;
- Grafikët duhet të përgatiten nga OE dhe të miratohen çdo vit nga AK bashkia Devoll. Grafikët mund të pësojnë ndryshime pasi të jenë miratuar nga AK, të cilat janë si vijon:
 1. Oraret e punimit në secilin rrugë dhe trotuar.
 2. Numrin e punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh.
- Dokumentacioni/ gjurmë auditimi për praninë e përfaqësuesit të OE të shërbimit në “Zyrën të kontaktimit” për marrjen e ankesave. Nuk ka asnjë ankesë/ vërejtje nga qytetarët nga qytetarët për pastrimin e bashkisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

- Listë prezencë për çdo ditë pune nga OE i shërbimit që detyrimisht duhet të ketë në çdo ditë në punë, minimalisht numrin e punonjësve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit,
- Nuk evidentohen PV të mbajtura nga mbikëqyrësit i punimeve ku të pasqyrohet inspektim e realizmit të shërbimit në çdo kohë apo në përfundimin e kryerjes së shërbimit të kontratës, respektimin e standardeve, rregullative dhe cilësinë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoha dhe ndalesa për mos përmbushje e kontratës.

Kështu referuar relacionit për hartimin e fondit limit në vlerën prej 48,607,640 lekë nga komisioni i Bashkisë Devoll, është parashikuar se për kryerjen e këtij shërbimi nevojiten 31 punëtorë (16 pastruese + 15 shoferë), me një fund pagash për 2 vite të kontratës në shumën prej 27,489,852 lekë, nga të cilat: vlera 20,837,952 lekë për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, ku për 2 vite për 16 punonjësit e pastrimit dhe 15 punonjës shofer duhet vlera prej 6,651,900 lekë.

Nga përlllogaritjet e bëra rezulton se kosto mesatare sipas përcaktimeve që janë bërë në relacionin e hartimit të fondit limit për 1 (një) punonjës pastrimi për 2 vite të kontratës është 1,302,372 lekë dhe për 1 (një) punonjës shofer 443,460 lekë. Gjithsej vlera mesatare për 1 (një) punonjës (1,302,372 lekë + 443,460 lekë) / 2 = 872,916 lekë (për 2 vitet e kontratës).

Sipas dokumentacionit në dosje të paraqitur në momentin e zbatimit të kontratës në terren evidentohet se shoqëria deklarohen gjithsej 27 punonjës ose më pak se numri i përcaktuar në fondin limit prej 4 punonjësish (31-27) dhe shumë herë më pak se numër i punonjësve të kërkuar në DST prej 28 punonjësish (55 -27).

Nisur nga kosto mesatare për 1 (një) punonjës të përcaktuar në relacionin për fondin limit, rezulton se për 27 punonjës të deklaruar kosto totale për fondin e pagave do të duhej të ishte 23,568,732 lekë (27 punonjës x 872,916 lekë), ose më pak se fondi i përcaktuar për realizmin e kontratës për vlerën 3,491,664 lekë (27,489,852 lekë – 23,568,732 lekë).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2021 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nenet 10, 12, 14, 18 dhe 21, si dhe VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, **shtojca 1.7** “Ekzistenca e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve është vendimtar para fillimit të llogaritjes së kostove, pasi ai do të sigurojë shumicën e informacionit teknik dhe infrastrukturor të nevojshëm për variablat e sistemit”.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për monitorimin e kontratës dhe në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve për verifikimin e punëve të kryera në terren nga sipërmarrësi, ku mbi bazën e volumit e punëve faktike dhe në raport me numrin e punëtorëve dhe mjeteve të angazhuar në fakt, sipas akteve të mbajtura për këtë qëllim dhe vetëm në bazë të këtyre akteve të hartohet situacioni përkatës për likuidimin e kontratave mujore dhe shmangur pagesat e tepërta në raport me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në llogaritjen e fondit limit me vlerë **3,491,664 lekë** nga bashkimi i OE “A...” ShPK.

Gjatë fazës së zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit

4.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll vetëm është ri-njoftuar subjekti me shkresë nr. 3655 prot., datë 01.11.2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të hartojë planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion dhe që kërkon shërbimin e pastrimit.

Gjatë fazës së zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

4.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll nuk u paraqit asnjë dokumentacion për realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll, 3 për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **98,023 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të procedurave të prokurimit me vlera të larta për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, rezulton se janë realizuar gjithsej 52 procedura me fond limit 1,125,880 mijë lekë dhe vlerë kontrate 997,197 mijë lekë, me një ulje prej 11% ose kursyer një fond për vlerën 128,683 mijë lekë.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit nga 52 procedura me fond limit 1,125,880 mijë lekë ka vlerësuar për auditim 21 procedura me fond limit 992,001 mijë lekë ose 81% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 21 procedurave, rezultuan në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave”, ku:

a- Në 7 procedura, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kriteret jo sipas llojit të procedurës dhe të paargumentuara, veprime të cilat çojnë në uljen e OE në procedura, si dhe

Veprime në paligjshmëri me ligjin.

b- Në 4 procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorim më efektiv të fondeve publike në vlerën 98,023 mijë lekë pa TVSh.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2000 neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “S`kualifikimi i ofertuesve”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

1.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll për procedurat në vazhdim kanë mbajtur në një rast Proces verbal nr. 2790/3, datë 16.08.2022, për procedurën e prokurimit “Pastrim Pylli”.

Rekomandimi është zbatuar

1.2 Rekomandimi: Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga një procedurë prokurimi e zhvilluar në vitin 2022 “Blerje Goma” është bërë argumentimi teknik është pjesë e dosjes me nr. 1809/6, datë 06.06.2022, por jo për dosjet e prokurimit të vitit 2021.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

1.3 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen e fituesve të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë 98,023 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga titullari i Bashkisë Devoll nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen e fituesve të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.

*KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll, 13 për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në vlerën **48,390,855 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.*

1. Gjetje nga auditimi: Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të viteve 2018 - 2021, rezulton se taksa e ndërtesës për familjarët aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjorë (*genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK*), duke përdorur tarifë fikse 100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Sektori i PZHT për lejet e ndërtimit dhe përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Korçë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi, ku



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

evidentohen gjithsej **192 persona** të cilëve nuk ju është llogaritur taksa e pasurisë (ndërtesës) për një vlerë **1,745,228 lekë**, si e ardhura e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll (të dhëna sipas Aneksi 2.6.2 bashkëlidhur Raportin Përfundimtar Auditimit), veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Devoll dhe ASHK Dega Rajonale Korçë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës) dhe arkëtimin e vlerës prej **1,745,228 lekë** sipas Aneksit 2.6.2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll ka bërë njoftimet për të gjithë personat dhe është bërë ndryshimi i sipërfaqes së ndërtesës për vitin 2022. Për sa i përket vlerës 1,745,228 lekë mbetet e paarkëtuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve dhe Drejtorinë e PZHT, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për evidentimin dhe plotësimin me dokumentacion ligjorë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentë familjarë të sipërfaqes së ndërtesave që ato disponojnë dhe taksimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2. Gjetja nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga subjekti mbi tarifën e pastrimit/gjelbërimit dhe ndriçimit dhe auditimi i tyre, rezultoi se në planifikim këto tarifa vijnë në ulje ku nga vlera 64,305 mijë lekë të planifikuara në vitin 2020 në vitin 2021 është planifikuar vlera 62,114 mijë lekë, pra më pak për shumën 2,191 mijë lekë, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Devoll.

Arkëtimi i tarifës së gjelbërimit/ pastrimit dhe ndriçimit për një pjesë të abonentëve familjarë bëhet me agjentë tatimorë, që është “Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizim” SHA, kryesisht ato që kanë kontratë me ujësjellësin.

Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e abonentëve familjarë, rreth 4885 familje të cilat nuk kanë kontratë me ujësjellësin nuk identifikohet mënyra e taksimit të tyre, dhënia e njoftimit detyrimit të vjeljes së tyre.

Kështu sipas të dhënave janë me kontratë me ujësjellësin 8578 familja nga 13463 familje që janë në gjithë Bashkinë Devoll. Pra gjithsej të pataksuar janë **4885 familje** të cilat sjellin mungesë të ardhurash në bashkisë Devoll për vlerën mesatare prej **6,448,200 lekë**, veprime në kundërshtim me pikën 3 e nenit 70 të ligjit nr. 9920, datë 18.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në cilësinë e Kryetarit të bordit drejtues “Ujësjellës Kanalizime SHA” Devoll, të miratojë në Këshillin e Bordit Drejtues “Ujësjellës Kanalizime SHA” si agjent tatimorë, që për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin të faturohet vetëm për tarifat e bashkisë, kjo për të bërë të mundur arkëtimin e tarifës së pataksuar në vlerën **6,448,200 lekë** të abonentëve familjarë pa kontratë me ujësjellësin.

Menjëherë

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), rezultoi se për një pjesë të objekteve TNI nuk është llogaritur në zbatim të Vendimeve të KB të viteve respektive (2018- 2021), duke evidentuar një të ardhur të munguar në shumën 1,780,458 lekë kjo për 9 subjekte (të dhëna në Aneksin 2.6.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (nga legalizimet), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë është në vlerën 15,759,003 lekë për 246 persona, nga të cilat kanë paguar detyrimet 174 persona me vlerë 8,754,806 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri më datë 31.12.2021 gjithsej 63 persona me vlerë 4,080,739 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll (lista sipas Aneksit 2.6.4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtarë të Auditimit). Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Devoll t’i jetë drejtuar ASHK Dega Korçë/Devoll, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe Vendim të KB nr. 91, datë 26.12.2017 (paketa fiskale për vitin 2018), Vendim të KB nr. 114, datë 24.12.2018 (paketa fiskale për vitin 2019), Vendim të KB nr. 95, datë 26.12.2019 (paketa fiskale për vitin 2020) dhe Vendim të KB nr. 94, datë 21.12.2020 (paketa fiskale për vitin 2021).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **1,780,458 lekë ndaj 9 subjekte**, si rezultat i llogaritjes gabim të TNI, si dhe arkëtimin e vlerës së taksës nga ndërtimet pa leje (ish-ALUZNI-t) për vlerën **4,080,739 lekë ndaj 63 personave (të dhëna sipas aneks 2.6.3 dhe 4, bashkëlidhur Raport Auditimit).**

Brenda datës 31.07.2022

3.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit pas njoftimit të subjekteve përkatëse, është arkëtuar shuma 171,729 lekë në datë 11.04.2023 me llogari veprimi BA1112000, vlera 244,800 lekë në datë 20.06.2022 me numër veprimi 005541, gjithashtu për dy leje në vlerën 192,733 lekë dhe 259,048 lekë është kërkuar informacion IMTV me shkresë nr. 2369 prot., datë 06.07.2022, dhe sipas përgjigjes së IMTV këto dy subjekte nuk kanë vënë në zbatim lejen në fjalë. Pra mbetet vlera 912,148 lekë.

Për vlerën 4,080,739 lekë ndaj 63 personave, është arkëtuar vlera në total 2,145,754 lekë për 33 subjekte me fatura pas datë 13.06.2022 e në vijim. Mbetet diferenca prej 1,934,985 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

3.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Korçë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.07.2022

3.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, është dërguar shkresë nr. 3159 prot., datë 22.09.2022, “Njoftim në lidhje me rekomandimin e lënë nga KLSH-ja”, ASHK Korçë.

Rekomandimi është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Devoll dhe nga auditimi i tyre, rezultojnë ushtrime të tregtimit të hidrokarbureve gjithsej aktivë 11 pika të tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tij, ku detyrimi për taksën e autorizimeve që subjekte duhet të likuidojnë është 11,000,000 lekë.

Kanë paguar detyrimin 7 subjekte me vlerë 7,000,000 lekë dhe 4 subjekte e kanë paguar atë pjesërisht, ku nga vlera 4,000,000 lekë është paguar vlera 1,600,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 2,400,000 lekë, si mungesë të ardhura në Bashkinë Devoll.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrëveshje është për detyrimet e palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,400,000 lekë** nga 4 subjektet, *respektivisht;*

- vlera **600,000 lekë** nga subjekti “T...” ShPK
- vlera **400,000 lekë** nga subjekti “R...” ShPK;
- vlera **600,000 lekë** nga subjekti “M...” ShPK;
- vlera **200,000 lekë** nga subjekti “I...” ShPK

Brenda datës 31.07.2022

4.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, ka bërë njoftime për subjektet, si dhe deri më tani kanë paguar në vlerën 200,000 lekë subjekti “R...” ShPK, në datë 20.09.2022, “M...” ShPK në vlerë 200,000 lekë në datë 27.06.2022, “I...” ShPK në vlerë 200,000 lekë në datë 24.10.2022.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, rezultojnë se nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme. **Nuk rezultojnë e ngritur zyra e menaxhimit të Aseteve (prona dhe toka) që të merret me administrimin dhe menaxhimin e Aseteve dhe marrjen në dorëzim të pronave që me Vendim të Këshillit të Ministrave i kalojnë në pronësi Bashkisë Devoll.**

Nga të dhënat mbi kontratat e qirave që operojnë në Bashkinë Devoll, rezultojnë se nga 15 subjekte që kanë lidhur kontratë në vlerën 2,411,296 lekë, për vitin 2021 nuk kanë paguar akoma detyrimin 2 subjekte me vlerë 950,000 lekë, e ardhur e munguar në buxhet.

Gjithashtu rezultojnë se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

1- Nga z. Y.C me detyrë ish- kryetar i Komunës Hoçisht, sot NJA Hocisht është lidhur kontratë qiraje datë 30.6.2015 me shoqërinë “A...” me sipërfaqe 42500 m² dhe afat përdorimi 30 vjeçar me objekti “Mbarështrin e florës dhe faunës”.

Lidhje e kontratës është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, ka përcaktuar qartazi se kohëzgjatja e kontratave bëhet për një periudhë nga 6-10 vjet, dhe jo 30 aq sa kërkuar nga bashkia dhe lidhur më tej kontrata me subjektin.

Tarifa mbi qiranë nuk është llogaritur saktë për vlerën 84,600 lekë (4.23 ha x 20,000 lekë/ha/vit) ose më pas se detyrimi sipas ish-komunës në vlerën 40,300 lekë (84,600 – 44,300) x 4 vite objekt auditim = **161,200 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.

2- Në ish-Komunën Miras është lidhur vetëm një kontratë për përdorimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në administrim të miratuar me VKM nr. 622, datë 14.05.2008 “Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve/kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Miras, të Qarkut Korçë”.

Nga ish-Kryetari z. K. S. është lidhur kontrata e qirasë me shoqërinë “...” me përfaqësues z. P.M, ku me shkresën nr. 1583/1, datë 24.11.2017 i është transferuar shoqërisë “A...” me pronar zj. M. N., për dhënie me qira të sipërfaqes inproduktive pyjore/kullosore prej 4810 m² (ose e konvertuar më km në sipërfaqe prej 3207 km), për shtrirjen e linjës së veprës marrje ujë, trase dhe 140 m² zall. Afati i përdorimit është 10 vite, nga datë 31.05.2011 deri me datë 31.05.2021. Nga përlllogaritjet rezultojnë se detyrimi që duhet të paguajë ndaj Bashkisë për gjatësinë 2 km, pasi 1.2 km janë pronë private, do të jetë 136,250 lekë/vit + 110.000 lekë/vit = 246,250 lekë në vit x 4 vite = 985,000 lekë, duke i zbritur shumën e paguar prej 279,980 lekë, të ardhurat e munguar në Bashki është në shumën **705,020 lekë**, mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Devoll.

3- Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezultojnë se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja, konkretisht tabela:

Nr.	Subjekti	Detyrimi sipas KLSH	Arkëtuar	Vlera e pa arkëtuar
1	M	2,482,980	-	2,482,980
2	I	1,155,000	1,155,000	-
3	K	17,238,800	-	17,238,800
	Shuma	20,876,780	1,155,000	19,721,780

Pra nga shuma e konstatuar si e patakshuar dhe paguar nga auditim i KLSH-së me vlerë 20,876,780 lekë, është arkëtuar vlera 1,155,000 lekë, duke mbetur pa arkëtuar vlerën 19,721,780 lekë, si e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, shtojca nr. 2.2 “Për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, pikat 3”, lidhjen 2, pasqyra 11, pika 6, të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ku vlera e qirasë është prej 145,000 lekë/km/viti, si dhe neni 15 i ligjit nr. 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe VKM nr.22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pika 3 e vijim, duke mos gjetur zbatim dhe pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006. **Ligjin nr.8743**, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, neni 8, ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, neni 6 dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, në **strukturën organizative të Bashkisë Devoll, si dhe** Udhëzimi nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”.

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për hartimin dhe miratimin e planit të mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme, kjo për efekt të realizimit të të ardhurave.

Të ngrihet gjithashtu Zyra e Menaxhimit të Aseteve, si dhe të shikohet mundësi e regjistrimit të pronave në ASHK kaluar me **VKM në pronësi të Bashkisë Devoll**.

Menjëherë

5.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, janë nxjerrë 60 certifikata pronësie deri në fund të vitit 2021 dhe për vitin 2022 janë nxjerrë 6 certifikata pronësie, aplikim nr. 2134, datë 16.09.2022 për pasurinë nr. 2/3 ZK nr. 1187 qyteti Bilisht.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pallogaritur dhe papaguar në shumë **19,055,020 lekë**, respektivisht:

- **vlera 650,000 lekë** nga shoqëria “V..” ShA;
- **vlera 300,000 lekë** nga shoqëria “I..” ShPK;
- **vlera 161,200 lekë** nga shoqëria “A..” ShPK;
- **vlera 705,020 lekë** nga shoqëria “A..” ShPK;
- **vlera 2,482,980 lekë** nga shoqëria “M..” ShPK;
- **vlera 17,238,800 lekë** nga shoqëria “K..” ShPK.

Brenda datës 31.07.2022

5.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve, ka bërë njoftimet subjekteve dhe ka paguar:

1. V... për vlerën 250,000 lekë në datë 04.05.2022;
2. I..., për vlerën 300,000 lekë në datë 28.02.2022;
3. A..., për vlerën 161,200 lekë në datë 27.07.2022.

Por nuk është dërguar në gjykatë asnjë kërkesë për shlyerjen e detyrimeve.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e dosjeve të kontratave të qirasë me objekt: “*Prodhimit të energjisë (fotovoltaik)*”, rezulton se:

a- Shoqëria “...” **ShPK** me NIPT L... është pajisur me licence për ushtrimin e veprimtarisë për prodhimin e energjisë elektrike me nr. 435, sipas vendimit të Bordit të ERE (Enti Rregullator



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

i Energjisë) nr. 13, datë 31.01.2019. Gjithashtu ky subjekt është pajisur dhe me leje zhvillimi nr. 6, datë 25.10.2019 si dhe leje infrastrukture nr. 01, datë 7.4.2020 për të cilën është llogaritur dhe derdhur taksa e ndikimit në infrastrukturë në masë 0.1% e vlerës së preventivit në masën 128,469 lekë likuiduar me datë 20.3.2020.

b- Ndërsa dy shoqëritë e tjera si “S...” ShPK dhe “N...” ShPK me të cilët është lidhur kontrata qira për shfrytëzimin e sipërfaqes për prodhim energjie, rezulton se kanë vijuar me procesin e ndërtimit pa u pajisur me leje infrastrukture dhe nga Kryeinspektori IMT Bashkia Devoll nuk është ushtruar kontroll dhe nuk është marrë në shkelje të akteve ligjore për ndërtim pa leje.

Sipas sistemit elektronik të lejeve, këto dy shoqëria kanë aplikuar vetëm për leje zhvillimore, konkretisht leja nr. 03, datë 02.11.2020 dhe leja nr. 02, datë 23.9.2020, duke mos aplikuar më tej për leje infrastrukture, mbi bazën e së cilës duke mos të llogaritej dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Kështu referuar plan-biznesit të paraqitur nga këto dy subjekte dhe në zbatim të paketës fiskale të bashkisë viti 2020, detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë i pallogaritur është si vijon:

1- Për subjektin “N...” ShPK me vlerë projekti 2,418,584 euro x 124.1 lekë (kursi sipas bankës së Shqipërisë) = 300,871,849 x 0.001% = 300,872 lekë.

2- Për subjektin “S...” ShPK me vlerë projekti 1,926,979 euro x 124.1 lekë (kursi sipas bankës së Shqipërisë) = 239,138 x 0.001% = 239,138 lekë.

Gjithsej detyrimi për TNI paraqitet në shumën 540,010 lekë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar, nenet 10 dhe 11 të tij; neni 41 dhe 52 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikim dhe Zhvillim Territori”, i ndryshuar, si dhe të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Prodhimit të Energjisë”.

6.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të ushtrorë kontroll në sipërfaqen e marrë me qira nga shoqëritë “S...” ShPK dhe “N...” ShPK, për ndërtimin e impiantit të prodhimit të energjisë (fotovoltaik), ku në rast të konstatimit të ndërtimit pa leje infrastrukture të lëshuar nga DPZHT Bashkia Devoll të aplikohen sanksionet sipas ligjit, duke pezulluar ndërtimin deri në marrjen e lejes.

Gjithashtu referuar vlerës së preventivit të hartuar nga subjektet dhe depozituar në DPZHT, të mos lëshohet leja e ndërtimit pa arkëtimin e TNI në shumën **540,010 lekë**, respektivisht:

- vlera **300,872 lekë** nga shoqëria “N...” ShPK;

- vlera **239,138 lekë** nga shoqëria “S...” ShPK.

Brenda datës 31.07.2022

6.2 Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll, për shoqërinë S... ShPK është pajisur me leje dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë është paguar në vlerën 179,001 lekë dhe diferenca është llogaritur më shumë për arsye të ndryshimit të projektit, dhe për shoqërinë “N...” ShPK, është pajisur me leje dhe ka paguar vlerën 321,671 lekë (diferencë kursi këmbimi).

Rekomandimi është zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT Bashkia Devoll, rezulton se struktura nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë, pasi asnjë nga punonjësit, përfshirë këtu dhe Kryeinspektorit nuk kanë arsimin përkatës sipas dispozitave ligjore.

Për periudhën e viteve 01.01.2018 deri 31.12.2021, për ndërtime të kundërligjshme/mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me gjobë **27 kundërvajtës** me vlerë totale **14,390,000lekë**. Nga kjo vlerë është arkëtuar vlera 2,100,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

lekë për 10 subjekte, ku për 3 subjekte me vlerë 1,500,000 lekë gjoba është falur me vendim gjykatë dhe është arkëtuar vlera 600,000 lekë për 7 subjekte, duke mbetur për likuidim vlera 12,290,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet, të dhëna të cilat paraqiten në *Aneks 2.6.5, bashkëlidhur Raport Auditimit*.

Për objektet e tjera për të cilat është marrë vendim prishje objekti (ndërtim pa leje), nuk janë përpiluar procesverbalet “Për prishje objekti” dhe procesverbal “Ekzekutim vendimi”, duke mos argumentuar dhe arsyet e mos zbatimit të këtyre vendimeve.

Gjithashtu nuk ka dokumentacion që vërteton se është vepruar në bashkëpunim me IMKT Dega Korçë për prishjen e tyre.

Për objektet e ngritura nën territorin e Bashkisë Devoll, të cilat janë pajisu me leje nga Drejtoria e PZHT, nga IMTV Bashkia Devoll, nuk ka një vlerësim të shkeljeve të punimeve në ndërtim, (nëse ka).

Për disa nga projektet e prokuruar në Bashkinë Devoll, IMTV nuk ka kryer asnjë procedurë për mbarëvajtjen apo pezullim të punimeve, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të këtij Inspektorati.

Nuk është kërkuar në Gjykatë, ndryshimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike Bashkia Devoll nuk ka marrë masat dhe nuk kanë kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat për 17 vendime me gjobë për ndërtimet e pa ligjshme për 17 kundërvajtës me vlerë **12,290,000 lekë**.

- Nga të dhënat e marra nga Policia Bashkiake, konstatohet se për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021 janë aplikuar gjithsej 129 gjoba me vlerë 270,500 lekë, nga e cila: janë arkëtuar deri me datë 31.12.2021, gjithsej 97 gjoba me vlerë 219,300 lekë dhe mbetet për arkëtim 32 gjoba me vlerë **51,200 lekë** (shënim: vlera e debisë është 219,300 mijë lekë, janë bërë pagesa 51,200 lekë nga totalja), e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll. Sipas llojit të gjobës të dhënat bashkëlidhur Aneksi 2.6/6.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me a-neni 16 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalja e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10 324, datë 23.9.2010, neni 3)

b-nga Kryeinspektori IMT, Drejtoria Juridike e Bashkisë Devoll përgjatë harkut kohor të 4 viteve nga data 01.01.2017 – 31.12.2020, nuk kanë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) **për 17 kundërvajtës** me vlerë totale **12,290,000 lekë**, të përcaktuara në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përkatësisht: neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv” dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve

c-Nga Sektori Juridike, Bashkia Devoll nuk është kërkuar në Gjykatë, ndryshimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

d- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike Bashkia Devoll nuk ka marrë masat dhe nuk kanë kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat për 27 vendime me gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015, deri më dt. 29.5.2017, për shumën **12,290,000 lekë**, në kundërshtim me nenet 151 dhe 152 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile në RSH “ i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe t’i rikërkojë edhe njëherë Inspektorati



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Kombëtar të Mbrojtjes Territorit Dega Korçë, hartime një plani të përbashkët veprimi duke e mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.1.1 Nga verifikimi rezultoi se, Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, nuk ka marrë masë për realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e **17** kundërvajtësve në vlerën **12,290,000 lekë** (sipas Aneks 2.6/5, bashkëlidhur Raport Auditimit), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, ka bërë njoftime subjekteve por kjo vlerë nuk është arkëtuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të vlerësojë mundësinë e strukturimit të IMT Bashkia Devoll me specialist me kualifikim në fushën e inxhinierisë (mundësisht të ndërtimit), për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3.1 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për këtë rekomandim.

Rekomandimi është zbatuar (sipas observacionit mëposhtëm)

Për sa më lart, Bashkia Devoll, ka paraqitur observacion e protokolluar me shkresë nr. 1622 Prot., datë 01.06.2023, protokolluar në KLSH me nr. 370/9 Prot., datë 05.06.2023, ku citohet: **Pretendimet e subjektit:** është plotësuar struktura me IMTV me një topograf me miratimin e strukturës së vitit 2023. Struktura Bashkëlidhur.

Qëndrimi i grupit të auditimit: pasi shqyrtoi kundërshtimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur, merr në konsideratë observacionin dhe bën ndryshimin e nevojshëm në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

7.4. Rekomandimi: Sektori i Policisë Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Buxhetit, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e **32** kundërvajtësve në vlerën **51,200 lekë** (shënim: vlera e debisë është 219,300 mijë lekë, janë bërë pagesa 51,200 lekë nga totalja) (sipas Aneks 2.6/6, bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.4.1 Nga verifikimi rezultoi se, janë arkëtuar deri me datë 03.05.2023, gjithsej 27 gjoba me vlerë 48,300 lekë dhe mbetet për arkëtim 70 gjoba me vlerë 171,000 lekë, e ardhur e munguar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

në buxhetin e Bashkisë Devoll. Nga ana e sektorit të Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Devoll nuk sjell akt - rakordim mujor dhe progresiv mbi ecurinë e realizimit të këtij rekomandimi prandaj nga ana e Sektorit të Menaxhimit Financiar nuk janë bërë kontabilizimi i tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Masa për uljen e borxhit tatimor

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll, 1 masë për uljen e borxhit tatimor në vlerën **46,204,726 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi gjendjen e debitorëve në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se në fund të vitit 2021 gjendja është në shumën 46,204,726 lekë nga vlera 27,734,416 lekë e paraqitur në vitin 2020, pra me një rritje në vlerën 18,470,310 lekë ose 66%, ku debitorët familjarë paraqiten në shumën 32,755,533 lekë ose 59% e totalit të debitorëve.

- Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV mbi masat e marra në lidhje me punën e kësaj drejtorie në arkëtimin e debitorëve, rezultoi se nga Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve në Bashkinë Devoll është ndjekur vetëm njëra hallkë në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve, ajo për bllokimin e llogarive në Bankat e nivelit të dytë, ku nga 109 subjekte me vlerë 11,745,478 lekë që është kërkuar arkëtim të detyrimit, janë zbatuar vetëm 38 subjekte me vlerë 4,097,922 lekë ose 34.8%.

Në lidhje me detyrimet për abonentët familjarë, sipas të dhënave të paraqitura, menaxhimi bëhej në dy mënyra, nëpërmjet Ujësullës Kanalizime sha (*abonentët me kontratë*) dhe nga vetë bashkia për personat që vijnë në bashki për kryerjen e punëve të ndryshme (abonentë me TF), por që ka dhe një pjesë të konsiderueshme të abonentëve familjarë, të cilat nuk paraqiten në Bashkinë Devoll për veprime të ndryshme dhe nuk u është ngarkuar njoftim detyrimi.

- Ekzistenca e një numri të konsiderueshëm të subjekteve me status pasiv/mbyllur, por që vijojnë të jenë debitorë, gjithsej 19 subjekte me vlerë 794,095 lekë, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh të paarkëtueshëm ose të keq.

Gjithashtu rezultoi se në totalin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, ekzistojnë 197 subjekte me vlerë debitor prej 8,654,497 lekë të cilat pavarësisht faktit se ushtrojnë aktivitet nuk paguajnë detyrimet, duke rritur vlerën e debisë nga njëri vit në tjetrin, ku 76 subjekte me vlerë 2,977,871 lekë janë debitorë që nga viti 2019.

-Në plotësimin e regjistrave, nuk ka një standard të unifikuar të mbajtjes së tyre dhe informacioni në më të shumtën e rasteve nuk pasqyron hapat e ndjekur për secilin subjekt, në lidhje me likuidimet e kryera në vazhdimësi, gjë që e bën të vështirë analizën në kohë reale të debitorëve, mënyrën e ndjekjes apo kohën e arkëtimit të detyrimit.

-Për një pjesë të subjekteve nuk janë nxjerrë njoftim detyrimet për vlerën e borxhit, por është kaluar direkt në zbatimin e hapave të mëvonshme.

-Nuk janë respektuar afatet ligjore nga një procedurë në një tjetër, duke çuar kështu në mos mbledhjen në kohën e duhur të detyrimit.

-Nuk u konstatuan raste për vendosje barrë sigurorese dhe hipotekore, apo Njoftim për bllokim të dokumentacionit të mjeteve në pronësi, nga institucionet përkatëse, pothuajse në shumicën e rasteve nuk ka konfirmim të pronës apo mjeteve që subjekti ka në pronësi, dhe mbi të gjitha nuk është vepruar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, neni 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **46,204,726 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve dhe Sektori Juridik Bashkia Devoll, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Korçë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të këqij.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimeve të paarkëtuara, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, ka njoftuar subjektet familjarë dhe fizik/juridik me shkresa në datë 11.05.2022 me numrat përkatës dhe për bizneset janë bërë njoftime me nr. 16, 20 dhe 22 prot., datë 25.07.2022, etj.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll, 24 masa *disiplinore*, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

G/1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e neni 58- “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e neni 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për 12 (dymbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

1- Znj. A.F, me detyrë Drejtor Finance për periudhën e auditimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2020, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” (me ndryshime) me Vendimin e KM nr. 25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

2- Z. G.H, me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontabilizimit të të Ardhurave dhe Shërbimit ndaj Tatimpaguesve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Planifikimi i të ardhurave jo i argumentuar, veprime të cilat çojnë në planifikimin e shpenzimeve të pambuluar me fonde nga mos realizmi i tyre dhe rritjen e vlerës së faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

- Mos realizmi i planit të të ardhurave në asnjë nga vitet objekt auditimi.

- Mos bashkëpunimi midis sektorëve të brendshëm të Bashkisë Devoll dhe jo vetëm, veprime të cilat kanë çuar në mos taksimin e saktë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentëve familjarë.

- Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore në raport me tokën e ndarë dhe taksimi sipas boniteteve.

- Lënia jashtë skemës së taksimit të familjeve të cilat nuk kanë kontratë me ujësjellësin, gjithsej 7108 familje me vlerë **9,382,560 lekë, si mungesë të ardhurash.**

Veprime këto në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Pika (ç) e nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, etj.

3- Z. I.D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektorati Tatimor, Kundërvajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos realizmi i planit të të ardhurave në asnjë nga vitet objekt auditimi.

- Mos ndjekja e plotë e procedurave për arkëtimin e debitorëve në vlerën 67,650,122 lekë, si mungesë të ardhurash deri më 31.12.2021.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Pika (ç) e nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, etj.

4- Znj. T.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të PZHT

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos llogaritje të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë të subjekteve të pajisur me leje ndërtimi, në zbatim të vendimeve të KB të viteve respektive (2018- 2021), duke evidentuar një të ardhur në munguar në shumën 2,033,852 lekë kjo për 11 subjekte, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe Vendim të KB nr. 91, datë 26.12.2017 (paketa fiskale për vitin 2018), Vendim të KB nr. 114, datë 24.12.2018 (paketa fiskale për vitin 2019), Vendim të KB nr. 95, datë 26.12.2019 (paketa fiskale për vitin 2020) dhe Vendim të KB nr. 94, datë 21.12.2020 (paketa fiskale për vitin 2021) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

5- Znj. E.H, me detyrë Përgjegjës i Sektori Juridik dhe Prokurimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga auditimi mëparshëm për arkëtimin e vlerës 19,721,780 lekë, si e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

6- Z. F.Z, me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 109-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të kontratës së shërbimit të pastrimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

7- Z. R.H, me detyrë specialist në DPZHT

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “*Kualifikimi ofertuesve*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “*Kontrata për punë publike*”, pika (5); neni 61 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, pika (2), paragrafi (2).

8- Z. A.L, me detyrë Përgjegjës Sektori i Emergjencave Civile

9- Zj. E.A, me detyrë Specialiste Prokurimesh

10- Z. R.K, me detyrë Specialist Integritit në BE

11- Z. S.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “*Kualifikimi ofertuesve*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “*Kontrata për punë publike*”, pika (5); neni 61 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, pika (2), paragrafi (2).

12- Znj. E.M, me detyrë Specialist Sek. Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “*Anulimi një procedure prokurimi*”, pika (1), germa (ç); neni (46) “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika (1); neni (53) “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime) dhe neni (66) “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika (3); neni (67) “*Klasifikimi ofertave*”; neni (68) “*Raporti përmbledhës*”; Kreu (VIII) “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”; neni (73) “*Mungesa e konkurrencës*”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (me ndryshime).

G/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës” për 6 (gjashtë) punonjës, si më poshtë:

1- Zj. A.H, me detyrë Specialist dhe kujdesin social, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale Shëndetësore dhe Strehimit.

2- Z. M.B, me detyrë Administrator NJA Miras.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

3- Z. A.C, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes

4- Z. R.H, me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Qendër

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarin e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “Anulimi një procedure prokurimi”, pika (1), germa (ç); neni (46) “Kualifikimi i ofertuesve”, pika (1); neni (53) “Shqyrtimi ofertave”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime) dhe neni (66) “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika (3); neni (67) “Klasifikimi ofertave; neni (68) “Raporti përmbledhës”; Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni (73) “Mungesa e konkurrencës”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (me ndryshime).

5- Z. M.M, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Mbrojtjes së Territorit Mjedisit

6- Z. N.L, me detyrë Kryeinspektor

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave në kontrollin e territorit dhe lejimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, veprime në kundërshtim me Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar, nenet 10 dhe 11 të tij; neni 41 dhe 52 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikim dhe Zhvillim Territori”, i ndryshuar, si dhe të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Prodhimit të Energjisë”.

- Mos marrja e masave për fillimin e procedurave të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) për 17 vendime gjobe në vlerën 12,290,000 lekë dhe mos kontabilizim të tyre.

- Nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me a-neni 16 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, **Neni 15-** (Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

H/3. Për të gjithë punonjësit tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore konkrete, i lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin e procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale.

I. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

J. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **6 ish- punonjësit** e mëposhtëm, ndaj të cilëve nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, *konkretisht:*

1. **J.M**, me detyrë ish- Përgjegjës ONE STOP SHOP
2. **Xh.L**, me detyrë ish-Administrator NJA Miras
3. **A.A**, me detyrë ish-Specialist IT
4. **E.K**, me detyrë ish- Përgjegjës Sek I Ujitjes dhe Kullimit
5. **D.Z**, me detyrë ish-Drejtor Agjencia e Shërbimeve Publike
6. **B.K**, me detyrë ish- Këshilltar i Kryetarit.

Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Devoll nuk u paraqit asnjë dokumentacion për realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Përmbledhëse e Masave

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime Gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	37	37	17	14		6
Masa për shpërbllim dëmi	5	5	3			2
Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike	3	3	1	1		1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara	13	13	3	6		4
Masa për Uljen e Borxhit Tatimor	1	1		1		
Masa Disiplinore	24	24				24

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Devoll për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve dhe ka dërguar në KLSH me datë 13.06.2022 Urdhrin nr. 185, datë 13.06.2022, ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave me shkresën nr. 4042 prot., datë 22.11.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, **por nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Devoll për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 50/9 prot., datë 23.05.2022, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi nr. 1.1: Nga Titullari i Bashkisë Devoll, të marren masa për:

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
- Kryerjen e investimeve në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
- Zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti.
- Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
- Plotësimin e vendeve vakante të pozicioneve të larta drejtuese në bashki sipas organikës së miratuar, kjo për një menaxhim më të mirë të veprimtarisë së menaxhimit financiar e kontrollit në këtë bashki.

Në vijimësi

2. Rekomandimi 3.1: Drejtorja e Financë/Buxhetit në bashkëpunim me Sektorët e tjerë në Bashkinë Devoll, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi nr. 4.1: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi nr. 4.2: Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit të tyre, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikuiduara*), në fund të periudhave ushtrimore, duke planifikuar ato që kanë të bëjnë me shërbimet dhe investimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Devoll.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Rekomandimi nr. 5.1: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Rekomandimi nr. 6.1: Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Rekomandimi nr. 6.2: Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Rekomandimi nr. 6.3: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Rekomandimi nr. 7.2: Sektori i Buxhetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi me të ardhurat e bashkisë të mos kryejë copëzimin e fondeve për të shmangur detyrimet e prapambetura që çojnë në një situatë të vështirë financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Rekomandimi nr. 7.3: Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

kujdesshme dhe të përgjegjshme si dhe të hartojnë një plan për respektimin e disiplinës buxhetore për investimet kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Rekomandimi nr. 8.1: Drejtoria e Financë/Buxhet të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, duke e debituar vlerën **16,552,583 lekë** për vitin 2020, për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore si dhe nga gjobat e IMT-së. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*” të vitit në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Rekomandimi nr. 12.1: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të krijuar dhe mbajtur regjistrimin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

13. Rekomandimi nr. 13.1: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa dhe të nxirren përgjegjësitë për komisionet që kanë kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve me profil drusor dhe metalik duke mos i bërë hyrje në magazinë me qëllim që më pas të shiteshin në formë ankandi.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Rekomandimi nr. 14.1: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetës Kanalizime Devoll” SHA me vlerë kontabël **45,434,140 lekë**, si dhe regjistrimin e pjesëmarrjes me 11% të kapitalit aksionar të “K...” me vlerë kontabël **413,750 lekë** në debi të llog. 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Rekomandimi nr. 16.1: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të bëjë sistemimin në kontabilitet të llog.230 “*Investime në proces*” dhe llog.202 “*Studime dhe kërkime*” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej **8,095,000 lekë** të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llog.202 dhe në kredi të llog.230

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi nr. 18.1: Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të marrë masa për të bërë sistemimin e llog. 466 “*Kreditore për mjete nën ruajtje*”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

17. Gjetje nga auditimi nr. 21.1: Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave Bashkia Devoll, gjatë hartimit të projektit/planit të të ardhurave nga taksat/ tarifave vendore, të planifikojë saktë treguesit e planit mbi baza reale, duke u mbështetur në mundësitë reale të aktivitetit në bashkinë Devoll, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të të ardhurave, duke respektuar kuotën 10% rritje nga njëri vit në tjetrin.

Në vijimësi

18. Rekomandimi nr. 22.2: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Rekomandimi nr. 24.1: Kryetari i Bashkisë Devoll të marrë masa për ngritjen e një strukture të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Rekomandimi nr. 25.1: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialist të fushës dhe të analizojë shkaqet dhe rrethanat e mos zbatimit të aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.4.2019 të lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë “A.” ShPK, me objekt: *...financimi nga shoqëria “A..” ShPK i materialeve të ndërtimit dhe karburanti që do të përdorin mjetet për ndërtimin e rrjetit të jashtëm për furnizimin e ujësjellësit të fshatit Miras nga burimi i valës të Sinicës, sipas projektit të hartuar për këtë qëllim në përputhje me specifikimet teknike të tij, të miratuara nga Bashkia Devoll, duke konkluduar mbi këtë aktmarrëveshje dhe nxjerrjen e përgjegjësisive.*

Menjëherë

B. SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi nr. 4.1: Kryetari i Bashkisë Devoll, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për monitorimin e kontratës dhe në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve për verifikimin e punëve të kryera në terren nga sipërmarrësi, ku mbi bazën e volumit e punëve faktike dhe në raport me numrin e punëtorëve dhe mjeteve të angazhuar në fakt, sipas akteve të mbajtura për këtë qëllim dhe vetëm në bazë të këtyre akteve të hartohet situacioni përkatës për likuidimin e kontratave mujore dhe shmangur pagesat e tepërta në raport me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në llogaritjen e fondit limit me vlerë **3,491,664 lekë** nga bashkimi i OE “A...” ShPK.

Gjatë fazës së zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit

2. Rekomandimi nr. 4.2: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të hartojë planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion dhe që kërkon shërbimin e pastrimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Gjatë fazës së zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit

C. ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Rekomandimi nr. 1.2: Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi nr. 1.3: Kryetari i Bashkisë Devoll, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen e fituesve të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë 98,023 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1. Rekomandimi nr. 1.1: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Devoll dhe ASHK Dega Rajonale Korçë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës) dhe arkëtimin e vlerës prej **1,745,228 lekë sipas Aneksit 2.6.2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtarë të Auditimit.**

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi nr. 1.2: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve dhe Drejtorinë e PZHT, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për evidentimin dhe plotësimin me dokumentacion ligjorë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentë familjarë të sipërfaqes së ndërtesave që ato disponojnë dhe taksimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi nr. 2.1: Kryetari i Bashkisë Devoll në cilësinë e Kryetarit të bordit drejtues “Ujësjellës Kanalizime SHA” Devoll, të miratojë në Këshillin e Bordit Drejtues “Ujësjellës Kanalizime SHA” si agjent tatimorë, që për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin të faturohet vetëm për tarifat e bashkisë, kjo për të bërë të mundur arkëtimin e tarifës së pataksuar në vlerën **6,448,200 lekë** të abonentëve familjarë pa kontratë me ujësjellësin.

Menjëherë

4. Rekomandimi nr. 3.1: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

prej **1,780,458 lekë ndaj 9 subjekte**, si rezultat i llogaritjes gabim të TNI, si dhe arkëtimin e vlerës së taksës nga ndërtimet pa leje (ish-ALUZNI-t) për vlerën **4,080,739 lekë ndaj 63 personave**.

Menjëherë

5. Rekomandimi nr. 4.1: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur nga 3 subjektet, *respektivisht*;

- **vlera 600,000 lekë** nga subjekti “T...” ShPK
- **vlera 200,000 lekë** nga subjekti “R...” ShPK;
- **vlera 400,000 lekë** nga subjekti “M...” ShPK.

Menjëherë

6. Rekomandimi nr. 5.1: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për hartimin dhe miratimin e planit të mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme, kjo për efekt të realizimit të të ardhurave.

Të ngrihet gjithashtu Zyra e Menaxhimit të Aseteve, si dhe të shikohet mundësi e regjistrimit të pronave në ASHK kaluar me **VKM në pronësi të Bashkisë Devoll**.

Menjëherë

7. Rekomandimi nr. 5.2: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pallogaritur dhe papaguar, *respektivisht*:

- **vlera 450,000 lekë** nga shoqëria “V...” ShA;
- **vlera 705,020 lekë** nga shoqëria “A...” ShPK;
- **vlera 2,482,980 lekë** nga shoqëria “M...” ShPK;
- **vlera 17,238,800 lekë** nga shoqëria “K...” ShPK.

Menjëherë

8. Rekomandimi nr. 7.1: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe t’i rikërkojë edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit Dega Korçë, hartime një plani të përbashkët veprimi duke e mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Rekomandimi nr. 7.2: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e **17 kundërvajtësve** në vlerën **12,290,000 lekë** (sipas Aneks 2.6/5, *bashkëlidhur Raport Auditimit*), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

10. Rekomandimi nr. 7.4: Sektori i Policisë Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Buxhetit, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin e 70 kundërvajtësve për vlerën **171,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. BORXHI TATIMOR

1. Rekomandimi nr. 1.1: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Devoll, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **46,204,726 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve dhe Sektori Juridik Bashkia Devoll, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Korçë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të këqij.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimeve të paarkëtuara, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë

F. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenit 58- “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”:

F.1 I rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënie e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për 12 (dymbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

2- Znj. A.F, me detyrë Drejtor Finance për periudhën e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2020, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” (me ndryshime) me Vendimin e KM nr. 25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

2- Z. G.H., me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontabilizimit të të Ardhurave dhe Shërbimit ndaj Tatimpaguesve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Planifikimi i të ardhurave jo i argumentuar, veprime të cilat çojnë në planifikimin e shpenzimeve të pambuluar me fonde nga mos realizmi i tyre dhe rritjen e vlerës së faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

- Mos realizmi i planit të të ardhurave në asnjë nga vitet objekt auditimi.

- Mos bashkëpunimi midis sektorëve të brendshëm të Bashkisë Devoll dhe jo vetëm, veprime të cilat kanë çuar në mos taksimin e saktë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentëve familjarë.

- Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore në raport me tokën e ndarë dhe taksimi sipas boniteteve.

- Lënia jashtë skemës së taksimit të familjeve të cilat nuk kanë kontratë me ujësjellësin, gjithsej 7108 familje me vlerë **9,382,560 lekë, si mungesë të ardhurash.**

Veprime këto në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Pika (ç) e nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, etj.

3- Z. I.D., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektorati Tatimor, Kundërvajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos realizmi i planit të të ardhurave në asnjë nga vitet objekt auditimi.

- Mos ndjekja e plotë e procedurave për arkëtimin e debitorëve në vlerën 67,650,122 lekë, si mungesë të ardhurash deri më 31.12.2021.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Pika (ç) e nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

4- Znj. T.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të PZHT

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos llogaritje të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë të subjekteve të pajisur me leje ndërtimi, në zbatim të vendimeve të KB të viteve respektive (2018- 2021), duke evidentuar një të ardhur në munguar në shumën 2,033,852 lekë kjo për 11 subjekte, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe Vendim të KB nr. 91, datë 26.12.2017 (*paketa fiskale për vitin 2018*), Vendim të KB nr. 114, datë 24.12.2018 (*paketa fiskale për vitin 2019*), Vendim të KB nr. 95, datë 26.12.2019 (*paketa fiskale për vitin 2020*) dhe Vendim të KB nr. 94, datë 21.12.2020 (*paketa fiskale për vitin 2021*) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

5- Znj. E.H, me detyrë Përgjegjës i Sektori Juridik dhe Prokurimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga auditimi mëparshëm për arkëtimin e vlerës 19,721,780 lekë, si e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

6- Z. F.Z, me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 109-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të kontratës së shërbimit të pastrimit.

7- Z. R.H, me detyrë specialist në DPZHT

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

8- Z. A.L, me detyrë Përgjegjës Sektori i Emergjencave Civile

9- Zj. E.A, me detyrë Specialiste Prokurimesh

10- Z. R.K, me detyrë Specialist Integritit në BE

11- Z. S.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

12- Znj. E.M, me detyrë Specialist Sek. Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullari i AK për zhvillimin e një procedure tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “Anulimi një procedure prokurimi”, pika (1), germa (ç); neni (46) “Kualifikimi i ofertuesve”, pika (1); neni (53) “Shqyrtimi ofertave”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime) dhe neni (66) “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika (3); neni (67) “Klasifikimi ofertave; neni (68) “Raporti për mbledhës”; Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni (73) “Mungesa e konkurrencës”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (me ndryshime).

F.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës” për **6 (gjashtë)** punonjës, si më poshtë:

1- Zj. A.H, me detyrë Specialist dhe kujdesin social, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale Shëndetësore dhe Strehimit.

2- Z. M.B, me detyrë Administrator NJA Miras.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “Kualifikimi ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (me ndryshime), neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

3- Z. A.C, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes

4- Z. R.H, me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Qendër

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarin e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “Anulimi një procedure prokurimi”, pika (1), germa (ç); neni (46) “Kualifikimi i ofertuesve”, pika (1); neni (53) “Shqyrtimi ofertave”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (me ndryshime) dhe neni (66) “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika (3); neni (67) “Klasifikimi ofertave; neni (68) “Raporti përmbledhës”; Kreu (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni (73) “Mungesa e konkurrencës”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (me ndryshime).

5- Z. M.M, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Mbrojtjes së Territorit Mjedisit

6- Z. N.L, me detyrë Kryeinspektor.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave në kontrollin e territorit dhe lejimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, veprime në kundërshtim me Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar, nenet 10 dhe 11 të tij; neni 41 dhe 52 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikim dhe Zhvillim Territori”, i ndryshuar, si dhe të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Prodhimit të Energjisë”.

- Mos marrja e masave për fillimin e procedurave të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjybes) për 17 vendime gjobe në vlerën 12,290,000 lekë dhe mos kontabilizim të tyre.

- Nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me a-neni 16 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, **Neni 15-** (Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3).

Për të gjithë punonjësit tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore konkrete, i lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin e procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Devoll”

“Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale.

F.3 Nga Kryetari i Bashkisë Devoll **kërkojmë** vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar sipas Planit të masave të miratuar.

Menjëherë

Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Devoll (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/apo proces zbatimi		Në Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pa zbatuar (Pa filluar procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	37	37	17	14	6									
III	MASA SHPËRBLIM DËMI (Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, në Financë)	5	5	3		2		4,434,864		4,434,864		943,200			3,491,664
IV	MASA DISIPLINORE	24	24			24									
	Me status nëpunësi civil	12	12			12									
	Me kontratë pune	6	6			6									
	Nuk janë në marrëdhënie pune	6	6			6									
V	MASA 3E	17	17	4	8	5		94,693,604		94,693,604		4,815,274			89,878,330
	Nga të cilat:														
1	Masa për eliminimin e efektit negativ në fondet publike	3	3	1	1	1		98,023		98,023					98,023
2	Masa për eliminimin e efektit negativ në të ardhura të munguara	13	13	3	6	4		48,390,855		48,390,855		4,815,274			43,575,581
3	Ulje borxhit tatimor	1	1			1		46,204,726		46,204,726					46,204,726
VI	Dhe të tjera masa nëse ka. Gjoha APP														

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËRORË TË KLSH-së

E.K(Përgjegjës grupi)

S.J

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B.D